



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 94/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.04.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se një veturë zyrtare me targë nr 3Z-285-05, rreth orës 13:00 është vërejtur në Shkollën e Mesme “ Pjetër Bogdani” në Ferizaj, duke bartur njerëz të cilët votonin në këtë shkollë.

**Neni 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcakton se:**

*PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Nga ankesa e parashtruar në PZAP, nuk mund të vërtetohen pretendimet ankimore ngase parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi. PZAP - i konstatoi se ankesa është e pabazuar, për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, andaj në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

A nr. 94/2012 më datën 30.04.2012.

